



Datë: 03.03.2025
Numër Protokolli: 1723/2025

A.nr.127/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.127/2025 të datës 17.01.2025, të parashtruar nga ankuesi V.Ç., kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 03.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.127/2025, e datës 17.01.2025 e parashtruar nga ankuesi, V.Ç.

II. Anulohet Konkursi me numër reference RN00015571, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa*” i shpallur me datë 22.10.2024 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në piken II të dispozitivit.

IV. Obligohet Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi, V.Ç. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 17.01.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e rekrutimit me numër referencës RN00015570, të shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datës 30.01.2025 ka proceduar kërkesat për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa kjo e fundit më datë 03.02.2024, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë, se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)
administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 339/2025 të datës 17.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; Vendimin për qasje në dokumente publike me numër protokolli 4818/2 të datës 26.12.2024; Kërkesën për qasje në dokumente publike me numër protokolli 4818 të datës 24.12.2024; Njoftimet nga SIMBNJ; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 23.12.2024; Diplomën me numër 4611 të datës 05.09.2014; Diplomën me numër 533-02/9-23 të datës 17.01.2023; Certifikatën e datës 14.10.2014; Certifikatën e datës 02.12.2015; Certifikatën e datës 24-25.05.2021; Certifikatën e datës 07-08.06.2021; Certifikatën e datës 28.06.2021; Certifikatën e datës 16.11.2021; Vërtetimin Ref.15-261/24 të datës 05.12.2024; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 31.01.2023, 31.01.2022, 27.02.2024, 31.12.2019 dhe 24.12.2020; Njoftimin me numër protokolli 4810 të datës 24.12.2024; Njoftimin me numër protokolli 6380 të datës 10.10.2023; Vendimin me numër protokolli 652 të datës 09.02.2024; Vendimin me numër protokolli 159 të datës 12.01.2024; Marrëveshjen me numër protokolli 635 të datës 08.02.2024; Konkursin me numër reference RN00014495 të datës 11.07.2024; Vendimin e Këshillit A.nr.1166/2024 të datës 26.09.2024; Konkursin me numër reference RN00013311 të datës 13.02.2024; Aplikacioni i kandidatit B.H i datës 21.11.2024; Vërtetimin e muajit Janar 2017; Referencën e punës të datës 08.07.2020; Vërtetimin e vitit 2021; Vërtetimin e datës 06.02.2023; Vërtetimin e datës 14.12.2023; Konkursin me numër reference RN00015570 të datës 22.10.2024; Testin me shkrim të ankuesit dhe kandidatit B.H; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe kandidatëve të refuzuar; E-mailin e datës 13.12.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshillit; Përgjigjen në ankesë të datës 03.02.2025; Aprovimin për hapjen e konkursit; Vendimin me numër protokolli 4503 të datës 04.12.2024; Akt emërimit me numër protokolli 3622 të datës 12.12.2012; Akt emërimit me numër protokolli 3644 të datës 13.12.2012; Vendimin me numër protokolli 1805 të datës 10.05.2024; Akt emërimit me numër protokolli 6604 të datës 18.10.2023; Vendimin me numër protokolli 181 të datës 15.01.2024; Akt emërimit me numër protokolli 4748 të datës 12.11.2018; Akt emërimit me numër protokolli 271 të datës 24.01.2019; Aplikacioni i ankuesit i datës 05.11.2024, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i B.H i datës 21.11.2024, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar; Formularët e vlerësimit individual të kandidatit B.H; Rezultatet e testit me shkrim.

Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 22.10.2024, ka shpallë Konkursin me numër reference RN00015570 për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa*, me afat të aplikimit nga data 23.10.2024 deri më 21.11.2024 .

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej njëzet e katër (24) kandidatë, ku prej tyre katërmëdhjetë (14) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesin, i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit, mirëpo në intervistën me gojë nuk është vlerësuar, si rrjedhojë ka arritur gjithsej 55.2 pikë të testit me shkrim, ndërsa sipas Njoftimit me numër protokolli 4810, lidhur me njoftimin e kandidati fitues, rezulton se kandidati fitues është B.H me gjithsej 86.2 pikë të arritura

Ankuesi, i pakënaqur me vlerësimin përfundimtar dhe zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes së të drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, duke pretenduar ndër të tjera këto shkelje: se është vlerësuar me zero pikë nga intervista me gojë dhe nuk ishte vlerësuar fare jetëshkrimi, kualifikimi arsimor i disa anëtarëve të komisionit nuk ishte adekuat me pozitën e shpallur, kandidati fitues nuk ka përvojën profesionale për të cilën është duke u zhvilluar procedura e rekrutimit, përmbajtja e testit me shkrim nuk përkon me pozitën përkatëse, komisioni nuk ka vlerësuar drejtë esenë e kandaitëve, ka shkelje të afateve ligjore të përcaktuara me dispozitat që rregullojnë procedurën e pranimit dhe rekrutimit në shërbimin civil, si rrjedhojë i njëjti ka kërkuar anulimin e konkursit në fjal.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit publik me numër reference RN00015570 për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa*, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Fakulteti Ekonomik; Kërkesat Specifike:* *Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Rrjedhimisht, Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratë Publike, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 2. *Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se pretendimi ankimor i ankuesit për shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë pranimin e kandidatëve në shërbimin civil dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike është i bazuar, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi, sipas konkursit të shpallur me numër reference RN00015570, për pozitën *Drejtues i Ulët- Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa* është kërkuar që kandidatët të kenë se paku tri (3) vite përvojë pune profesionale, ndërsa nga analizimi i dosjes se datës kandidatit fitues, B.H, Kolegji ka gjetur se i njëjti ka plotësuar kriterin arsimor ngase ka bashkëngjitur Diplomën me Nr.10865 të datës 13.02.2020, mbi të cilin dokument dëshmohet se i njëjti

më datë 11.02.2020 ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik të Universiteti të Prishtinës, Departamenti Menaxhment dhe Informatikë, duke fituar kështu titullin Bachelor, mirëpo i njëjti nuk ka plotësuar kriterin e përvojës sepse kandidati në fjalë nuk ka tri vite përvojë pune profesionale pas diplomimit për fushën të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit, fakt ky i vërtetuar nga dokumentacioni i bashkangjitur në aplikacionin e tij të datës 21.11.2024, ngase lidhur me kriterin e përvojës së punës, i njëjti ka ofruar si dëshmi: vërtetimin e muajit janar 2017, të lëshuar nga Sekretariati i Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve, me të cilën dëshmohet se i njëjti nga 08.11.2016 deri më 08.01.2017, ka qenë i angazhuar në pozitën *Zyrtar i Logjistikës* në QNR; referencën e punës të datës 08.07.2020, me të cilën dëshmohet se i njëjti, nga muaji maj-korrik 2017, shtator-dhjetor 2017, si dhe shtator-dhjetor 2019 ka qenë i angazhuar në pozitën *Zyrtar i Logjistikës* në QNR; Vërtetimin e vitit 2021, të lëshuar nga Sekretariati i Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve, me të cilin dëshmohet se i njëjti, nga data 09.07.2021 deri më 08.12.2021, ka qenë i angazhuar në pozitën *Zyrtar i Listës Votuese*; Vërtetimin me numër protokolli 533 të datës 06.02.2023, të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me të cilën dëshmohet se i njëjti nga data 15.02.2022 deri më 14.02.2023, ka qenë i angazhuar në pozitën *Konsulent për Pagesa Direkte*; Vërtetimin me numër protokolli 8144, të datës 15.12.2023, të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me të cilën dëshmohet se të njëjtit, i është vazhduar kontrata-*Shërbime për Konsulent*, dhe atë nga data 20.04.2023 deri më 19.04.2026. Kështu që, bazuar në gjendjen e këtyre fakteve, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidati B.H, deri në datën e aplikimit posedon 2 vite e 7 muaj përvojë pune dhe atë *Konsulent për Pagesa Direkte* dhe *Shërbime për Konsulent*, andaj i njëjti nuk ka përmbushur kriterin e përvojës së punës siç përcaktohet me konkursin përkatës sepse përvoja e punës tek KQZ në cilësinë e Zyrtarit së Listës Votuese, nuk cilësohet përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës ashtu siç e njëjta nuk përkon as me fushën e studimeve themelore të diplomimit të ankuesit, gjegjësisht atë të Fakultetit Ekonomik, dhe se po ashtu i njëjti me rastin e aplikimit në konkursin në fjalë nuk ka kompletuar aplikacionin e punësimit ngase nuk ka bashkangjitur dëshminë që vërteton se nuk ka masë disiplinore për shkelje të rënda në fuqi, siç edhe është kërkuar me shpalljen e konkursit të datës 22.10.2024.

Tutje, Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i provave materiale të kësaj çështje ka gjetur se edhe ankuesi, nuk ka dorëzuar dokumentet e kërkuara sipas konkursit të shpallur me numër reference RN00015570, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi për pozitën përkatëse është kërkuar që kandidatët të kenë *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor)*. Fakulteti Ekonomik, ndërsa nga analizimi i dosjes së ankuesit, rezulton se i njëjti si dëshmi lidhur me kualifikimin arsimor ka bashkangjitur dy herë Diplomën e njëjtë me Nr.553-02/9-23 të datës 17.01.2023 të lëshuar nga Kolegji “Riinvest”, mbi të cilin dokument vërtetohet se i njëjti më datë 12.12.2022, ka mbrojtur tezën e studimeve Master, duke fituar kështu gradën Master i Arteve në Menaxhment me Specializim në Menaxhim të Sistemeve Financiare dhe Informatike, andaj rezulton se ankuesi nuk ka bashkangjitur Diplomën e Studimeve Bachelor, sikurse është kërkuar në shpalljen e konkursit.

Andaj, nisur nga rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë të kandidateve që plotësojnë kriteret e konkursit, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe si rrjedhojë gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa*, janë përfshirë në listë të ngushtë edhe kandidatë të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit, dhe se njëri prej tyre është shpallur edhe kandidat fitues, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 44 paragrafi 5 dhe 6, ku përcaktohet se: 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional

kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe 1.7 të këtij Ligji.

Andaj nisur nga konstatimet si më sipër, e duke u mbështetur në provat e ofruara nga MBPZHR, Kolegji i Këshillit, konstaton se fillimisht verifikimi paraprak është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe të konkursit për arsyet e cekura si më lartë, duke vepruar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe 1.7, nenin 44 paragrafi 5 nën paragrafi 5.1 dhe paragrafin 6 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, kështu procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00015570 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa, është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara, andaj edhe Njoftimi me numër protokolli 4810 i datës 24.12.2024 për publikimin e rezultateve përfundimtare me kandidatin fitues dhe çdo veprim tjetër në këtë procedurë të pranimit janë të pavlefshme.

Përkitazi me konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se bazuar në dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi, organi i punësimit respektivisht Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë së Zhvillimit Rural, janë të obliguar të ndërmarrin të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qellim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.127/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit V.Ç.;
- Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.